

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Valon Totaj anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) Sh.A, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj R.B., kundër të paditurit A.M. nga Gjakova, rr.“...” nr., për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.473/09, të datës 29.01.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditurit A.M. nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.473/09, i datës 29.01.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.473/09, të datës 29.01.2014, e ka detyruar të paditurin që t’ia paguaj paditëses shumën prej 953,97 euro, në emër të borxhit, me kamatë përkatëse ligjore të cilën e paguajnë Bankat Komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë, në afat mbi një vit pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedhë nga data 06.04.2009 (dita e parashtrimit të padisë në Gjykatë) e tutje, e deri në pagimin definitiv, sidhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 30.00 euro, e krejt këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të cenimeve të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 06.04.2009, asokohe në Gjykatën Komunale në Gjakovë, paditësja ka paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit si e bazuar, të obligohet i padituri t’i paguajë paditëses në emër të borxhit shumën prej 953.97 euro me kamatë në lartësi prej 3.5%, të cilën e paguajnë bankat komerciale duke filluar nga dita e parshtrimit të

padisë e deri në ditën e pagesës dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh, nën kërcenimin e përmbartimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.473/09, të datës 29.01.2014, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga raportet e historisë të klientëve më nr.200117895 të datës 01.04.2009, në mënyrë të padyshimtë është argumentuar fakti se i padituri, palës paditëse i ka borxh shumë prej 953.97 euro, në emër të shfrytëzimit të telefonisë fikse me nr. të telefonit XYZ-XYZ, si dhe nga Kontrata mbi pagimin e borxhit me këste me numër të kosumatorit 0000000, të lidhur në mes të ndërgjyqësve me datë 04.04.2008, vërtetohet se i padituri është darkorduar që borxhin në lartësinë e kërkesëpadisë ta paguajë në këste mujore-këstin e parë më datë 01.05.2008 në lartësi prej 25.00 euro, deri me datën përfundimtare 01.04.2011, pra deri në përmbushjen definitive të borxhit, për çka edhe kjo gjykatë ka ardhur në përfundim dhe ka vërtetuar se ekziston detyrimi juridik civil i të paditurit ndaj paditëses, për borxhin në shumë e cekur si më lartë dhe se nuk kemi parashkrim të kërkesës së paditësit konform dispozitave të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar pretendimin ankimor të ankuesit se paditësja është dashtë t'a padisë babain e të paditurit dhe jo të paditurin, si dhe borxhi është i një periudhe të gjatë kohore dhe si i tillë është parashkruar. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të dhënë në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, ku në mënyrë të saktë dhe të plotë janë dhënë arsyet ligjore se pse në rastin konkret nuk kemi parashkrim të

kërkesës së paditësit sipas nenin 378 parag.1 të LMD-së, ndërsa sa i përketë asaj se borxhi nuk i takon të paditurit, por babait të tij, në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka marrë dhe vlerësuar si provë kontratën mbi pagimin e borxhit me këste të lidhur në mes të ndërgjyqësve, në bazë të së cilës vërtetohet fakti se i padituri i ka borxh paditëses dhe atë shumën prej 953,97 euro, të cilën shumë nuk e ka kundërshtuar me asnjë provë ose fakt.

Si rrjedhojë, nuk qëndrojnë edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e atakuar, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenit 262 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashihet se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë. Gjukata e Apelit e pranon si të drejtë edhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket gjykimit të kamatës ligjore, përkatësisht lartësisë dhe kohëzgjatjes së saj, pasi që e njëjta është gjykuar në përputhje të plotë me nenin 277 parag.1 të LMD-së.

Gjukata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjukata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2105/14, datë 17.09.2018

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka